

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti Për Krimeve Të Rënda, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Ardita Azemi, në lëndën penale kundër të pandehurës T.G, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.779/15 të dt.07.03.2017, pas shqyrtimit fillestar me datë 30.06.2017, në të cilën ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit - Hivzi Bajraktari dhe e pandehura T.G, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

**E pandehura: T.G**, e bija e I dhe L, e gjinisë Sh, e lindur me dt. *data e lindjes*, me vendbanim në P lagja "...", Hyrja . nr. ., e papunësuar, e martuar, nënë e tre fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, e identifikuar me LNJ të RKS me nr. personal *numer personal*, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTORE

**Sepse:** me datë 04.10.2015 rreth orës 18:30 në banesën e të dyshuarës në Prishtinë në lagjen "...” në dhomën e fjetjes është gjetur arma e zjarrit-pistoleta e markës "TT" e kal. 7.62 mm, M57, me nr. serik C-37879, ngjyrë e zezë, 34 copë fishekë të kal. 7.62mm, 50 copë fishekë të kal. 9mm dhe 1(një) karikator i zbrastë, për të cilën pistoletë nuk ka pasur leje valide nga organet zyrtare konform Ligjit për Armë.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,42,43,46,69,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, e gjykon:

### DËNIM ME GJOBË

**Të pandehurës T.G, i caktohet dënim me gjobë prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim është e obliguar t'a paguaj në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

Nëse e pandehura nuk e paguan dënimin e shqiptuar, do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro të gjobës së pa paguar do t'i llogaritet një ditë burgimi.

Obligohet e pandehura qe te paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komform nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPK-së konfiskohet: 1 (një) pistoletë e markës “TT” e kalibrit 7.62, M57, me numër serik C-37879, ngjyrë e zezë, 34 copë fishekë të kalibrit 7.62 mm, 50 fishekë të kalibrit 9 mm dhe 1 (një) karikator i zbrazët.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.779/2015, të datë 07.03.2017, me të cilën e ka akuzuar të pandehurën T.G, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Me datë 30.06.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP/I.nr.779/2015, të datë 07.03.2017, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykes pas i bind se e pandehura e ka kuptuar akuzën, të njëjtës i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet e pafajshme.

E pandehura T.G, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, armën e ka mbajtur në një kohë kur është kthyer nga SHBA së bashku me tre fëmijët e saj, kanë qëndruar në një banesë pasi burri nuk i ishte kthyer ende nga SHBA. Meqë kishte dëgjuar shumë fjalë lidhur me sigurinë në Kosovë nga njerëz të ndryshëm, këtë armë e ka marrë për vetëmbrojtje edhe pse nuk ka ditur as të manipuloj me të mirëpo tani e ka kuptuar se armëmbajtja pa leje është veprë penale. I vjen shumë keq për veprën e kryer dhe i ka premtuar Gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla, tani i është kthyer bashkëshorti nga Amerika dhe ndihet më e sigurt.

Prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari, pas deklarimit të të pandehurës, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës T.G për veprën penale të përshkruar si në aktakuzë pasi që një pranim i tillë është komfor nenit 248 të KPK-së dhe në përputhje me gjitha provat që gjinden në shkresat e lëndës andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga e pandehura.

Meqenëse e pandehura e ka pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, e pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza, siç janë: Kallëzimi Penal, Vërtetimi për bastisjen e shtëpisë i dt. 04.10.2015 me listën për mjetet e konfiskuara, Aktvendimi për fillimin e hetimeve kundër të dyshuarës i dt. 03.03.2017 dhe deklarata e të dyshuarës e dhënë në Prokurori me dt. 06.03.2017 si dhe shkresat tjera të lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurën mori pranimin e fajësisë, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurës, rrethanat e saja familjare e njëjta është e martuar është

nënë e tre fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurës i shqiptoi dënim me gjobë si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurën nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjenerale që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**PKR. nr.106/17, datë 30.06.2017**

**Sekretarja Juridike:**  
**Ardita Azemi**

**Gjyqtari:**  
**Arben Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.